



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në bazë të nenit 12, dhe nenit 17 paragrafi 1, shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, në nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në shkresën përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 1019-2/22 të datës 25.03.2022, në mbledhjen e mbajtur më _____2022, miratoi këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 15NR.350/11334 I DATËS 28.02.2022 PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRMIRËSIMIN DHE HARMONIZIMIN E MOSPËRPUTHJEVE TË VLERAVE TË VEÇANTA TEKNIKE TË CAKTUARA ME HARTËN ZONALE TË KOMUNËS

Neni 1

1.ANULOHET, Vendimi, 15Nr.350/11334 i datës 28.02.2022, për fillimin e procedurës për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartën zonale të Komunës i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 28.02.2022.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 , Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 dhe Shkresës përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 1019-2/22 të datës 25.03.2022

Me Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 1019-2/22 të datës 25.03.2022 është kontestuar ligjshmëria e Vendimit 15Nr.350/11334 i datës 28.02.2022, për fillimin e procedurës për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartën zonale të komunës të miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 28.02.2022 me arsyetimin se me dispozitat përkatëse ligjore nuk parashihet mundësia e fillimit të procedurës për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartat zonale të komunave. Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që me qëllim të përmbushjes së Rekomandimeve të MMPHI të bëjë miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 1-DM/01-18290

Lipjan, më 02.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLICIT KOSOVO	
MINISTRIA E MIEDIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE	
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. i Faqëve Br. Stranica No. Pages	Datum: Date:
DC	1019-2/22
-02-	25.03.22
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPHI Date: 16.03.2022
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor
Lënda:	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendimi është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi Vendimi Nr.15-350/01-11334 për fillimin e procedurës për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartën zonale të komunës, miratuar nga KK Lipjan

I nderuari Kryetar Ahmeti,
I nderuar Azemi,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura (MMPHI) ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.15-350/01-11334 për fillimin e procedures për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartën zonale të komunës, miratuar nga KK Lipjan

I miratuar më datë: 28.02.2022

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.03.2022

I dërguar për shqyrtim në MMPHI më datë: 08.03.2022

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së Vendimit Nr.15-350/01-11334 për fillimin e procedures për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartën zonale të komunës, miratuar nga KK Lipjan, vlerëson se akti është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, konstatoi se Vendimi Nr.15-350/01-11334 për fillimin e procedures për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartën zonale të komunës, miratuar nga KK Lipjan, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, dispozitat e Udhëzimit Administrativ mmph- nr.08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit hapësinor dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ mmph- Nr.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, për shkak se dispozitat e të njëjtave nuk parashohin mundësin e fillimit të procedures për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartat zonale të komunave.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.